



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 241 Dt 07.02.2024

Në bazë të nenit 19, pika 1, të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, nenit 28 paragrafi 2 të statutit të UIBM, Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 05.02.2024, mori vendim të shpall:

KONKURS

për zgjedhjen e rektorit/es të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën e rektorit/es, përvec kërkesave të përgjithshme si në paragrafin 1 të nenit 9 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet në vijim:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencor dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, profesorit të asocuar ose profesorit asistent.
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.
3. Të mos ketë qenë në pozita udhëheqëse në ndonjë parti politike apo në listë zgjedhore të ndonjë partie politike ose koalicioni në nivel qendror apo lokal në tri (3) vitet e fundit.

Procedura e përzgjedhjes:

- Konkurrimi për postin e rektorit/es është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.
- Komisioni profesional, i zgjedhur nga Senati, ia propozon Këshilli Drejtues listën e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet e konkursit për t'u zgjedhur.
- Këshilli Drejtues i interviston kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në intervistë, secili/a kandidat/e prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së Universitetit dhe për qasjen e tij/saj menaxhuese.
- Rektorin/en e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional prej pesë (5) anëtarëve, të cilin e formon Senati. Komisioni profesional e ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit/es i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- Zgjedhja e rektorit/es bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës, Ligjit për Zyrtarët Publik, Statutit dhe Rregullores për punën e Këshillit Drejtues.
- Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit/es, për shkak të konfliktit të interesit aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

- Rektori/ja zgjidhet me shumicën e anëtarëve të përgjithshëm në pajtim me dispozitat e Statutit. Në rast se asnjë kandidat/e nuk e fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy (2) kandidatët/et me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse asnjëri nga dy (2) kandidatët/et nuk e fiton shumicën absolute tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, siç është paraparë në Statut.
- Zgjedhja e rektorit/es bëhet për mandatin e mbetur 2023-2027.

Kërkesës për aplikim, kandidatët/et duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër,
- Certifikatën ose ekstraktin e lindjes,
- Dokumentin e identifikimit;
- Kopjet e diplomave apo dëshminë mbi përfundimin e studimeve pasuniversitare, sipas rastit (studimet jashtë vendit) dhe dëshminë e nostrifikimit të diplomave;
- Vendimin/certifikatën apo ekuivalente të titullit akademik,
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxheriale në arsimin e lartë;
- Dëshminë që nuk është i/e denuar për ndonjë vepër penale.

Dokumentacioni i pakompletuar në formë fizike dhe elektronike dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret parasysh.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune, prej orës 09:00-16.00, në Zyrën e arkivit në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, rruga "Ukshin Kovaçica", 40000 Mitrovicë, Republika e Kosovës.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (të skanuara), në adresën konkursi.rektorit@umib.net.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen zyrtare të UIBM, përkatësisht nga data 07.02.2024 deri më 21.02.2024, në orën 16.00.

